



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.5, 15.1 dhe 21.2 të Ligjit për Aviacionin Civil Nr. 03/L-051,

Duke pasur parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si "Marrëveshja për HPEA") në emër të Kosovës, nga ana e UNMIK-ut, si dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes për HPEA për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka pranuar obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshirë edhe ato të lidhura në emër të saj nga UNMIK-u,

Duke pasur parasysh obligimin nga Marrëveshja për HPEA, që Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 736/2006 e 16 majit 2006 mbi metodat e punës për inspektimet standardizuese të Agjencisë Evropiane mbi Sigurinë e Aviacionit, të jetë pjesë e rendit të brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 11/2010
MBI METODAT E PUNËS PËR INSPEKTIMET STANDARDIZUESE TË
AGJENCISË EVROPIANE MBI SIGURINË E AVIACIONIT

Neni 1

1.1 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 736/2006 e 16 majit 2006 mbi metodat e punës për inspektimet standardizuese të Agjencisë Evropiane mbi Sigurinë e Aviacionit (EASA), këtej e tutje referuar si Rregullorja e Komisionit, shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 736/2006 i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe formon pjesën e saj përbërëse.

1.2 Dispozitat e neneve 1 deri 18 të Rregullores së Komisionit, janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

1.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të Rregullores së Komisionit, të përfshirë në Shtojcën I të Marrëveshjes për HPEA, do të jenë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Neni 2

2.1 Përkufizimet e termave dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore janë ato të përfshira në Nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

2.2 Pavarësisht nga paragrafi 1, termet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Europiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", nëse referohen në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

2.3 Për qëllim të kësaj Rregulloreje "autoritete kombëtare të aviacionit", siç referohet në Rregulloren e Komisionit, në lidhje me Republikën e Kosovës nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

2.4 Për qëllim të kësaj Rregulloreje "personel i autorizuar i Shteteve Anëtare", siç referohet në Rregulloren e Komisionit, në lidhje me Republikën e Kosovës do të thotë personat e autorizuar zyrtarisht nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës për të ndihmuar Agjencinë në kryerjen e inspektimeve.

Neni 3

Zbatimi i dispozitave të Rregullores së Komisionit lidhur me kryerjen e funksioneve dhe detyrave të EASA-s në emër të shteteve anëtare, në lidhje me Republikën e Kosovës, do të jenë subjekt i aranzhimeve të punës midis EASA-s dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Në rast të ndryshimit të verzioneve të përkthyer në gjuhët shqipe dhe apo serbe me verzionin original në gjuhën angleze të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 736/2006, versioni në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian do të ketë përparësi.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi me 15 nëntor 2010.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm